



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR FURNIZIM ME DERIVATE TË NAFTËS

E lidhur në Prishtinë, më datë **17.10.2023**, ndërmjet:

1. **HIB Petrol SH.P.K.** me numër unik identifikues **810662834**, me adresë në Magjistralla Ferizaj – Prishtinë, Talinoc i Muhaxherëve p.n, Komuna Ferizaj 70000, Kosovë. Tel.+383(0)38 777 777, E-mail: info@hibpetrol.com, përfaqësuar sipas Autorizimit nga z. Etrit Ademaj. (Këtu e tutje referuar si “**HIB Petrol ose Shitësi**”).

dhe

2. **Sindikata e Policisë së Kosovës** me numër fiskal **600595899**, me adresë në Rr. Luan Haradinaj p.n, Prishtinë, Tel.383(0)385080/1300, E-mail:info@spk-rk.eu, përfaqësuar nga Kryetari z. Imer Zeqiri (Këtu e tutje referuar si “**Sindikata ose Blerësi**”).

DUKE QENË SE HIB Petrol është kompani e licencuar për shitje me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës, dhe se posedon Pika shitëse të derivateve të naftës nëpër Kosovë;

DUKE QENË SE Sindikata e Policisë së Kosovës përfaqëson Anëtarët e saj e cila dëshmohet përmes kartelave të anëtarësisë dhe letërnjoftimit;

DUKE QENË SE përmes kësaj Marrëveshje, palët pajtohen që HIB Petrol të ofrojë zbritje në furnizim me derivatë të naftës për Anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës;

Atëherë, palët janë pajtuar si vijon:

Neni 1 - Objekti i marrëveshjes

1. HIB Petrol bën shitjen e derivateve të naftës tek Anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës në përputhje me kushtet, çmimin dhe afatet e parashikuara me këtë marrëveshje.
2. Shitja e derivateve të naftës bëhet në kuadër të pikave shitëse me pakicë të HIB Petrol, sikurse mund të ndryshojnë kohë pas kohe.
3. Derivatet e naftës të shitura janë të cilësisë sipas kërkesave teknike dhe ligjore të Republikës së Kosovës për produkte të naftës dhe nuk përfshijnë asnjë garancion shtesë.

4. Kjo marrëveshje është një Marrëveshje Kornizë që përfshin më shumë se një furnizim/shitje të derivateve të naftës. Çdo blerje specifike e produkteve të naftës konsiderohet një shit-blerje e veçantë, dhe qeveriset sipas kushteve të kësaj marrëveshje. Marrëveshja nuk parashikon asnjë detyrim shtesë për HIB Petrol përpos furnizimin me derivate të naftës.

Neni 2 - Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri më datë **31.12.2024**, me mundësi vazhdimi. Vazhdimi i marrëveshjes do të bëhet vetëm me shkrim në formë të një marrëveshje të re apo aneks marrëveshje.

Neni 3 – Çmimi, mënyra e blerjes dhe kushtet e pagesës

1. Çmimi përcaktohet sipas çmimit të aplikueshëm me pakicë i cili është publik në kuadër të pikës shitëse të HIB Petrol në momentin e blerjes së sasisë specifike të naftës. Në rast të çfarëdo paqartësie për çmim, aplikohet çmimi ditor i aplikuar i HIB Petrol në kuadër të pikave me pakicë në ditën e furnizimit. Kalkulimi i çmimit bëhet për furnizimin në kuadër të pikës shitëse dhe nuk përfshinë transport apo ndonjë shërbim tjetër.
2. Anëtarët e Sindikatës bëjnë pagesën për derivatet e naftës të blera, në formën cash në momentin e furnizimit.
3. **HIB Petrol do të ofrojë zbritje në vlerë 7 (shtatë) cent për litër, për të gjithë Anëtarët e Sindikatës. Anëtari i Sindikatës së Policisë së Kosovës në momentin e furnizimit duhet të paraqesë kartelën e anëtarësisë dhe letërnjoftimin në mënyrë që të dëshmojë anëtarësinë dhe të përfitojë zbritjen.**
4. HIB Petrol do të pajisë me kartela të furnizimit Anëtarët e Sindikatës të cilët janë të obliguar të paraqesin këtë kartelë në momentin e furnizimit. Secili furnizim i bërë bazuar në paraqitjen e kartelës do të regjistrohet në sistemin e pagesave të HIB Petrol dhe regjistrohet në kartelë.
5. Blerësit nuk i lejohet dhe nuk do të kërkojë ndryshim të çmimit (zbritjes) për shkak të kërkesës për kompensim të çfarëdo dëmi, duke përfshirë por mos u kufizuar në pretendime në lidhje me cilësinë dhe defektet, garancionin, apo shërbimet.

Neni 4 - Obligimet e palëve

1. Palët detyrohen që t'i respektojnë detyrimet që lindin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi duke i përmbushur ato në përpikëri në pajtim me këtë marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.
2. Palët zotohen se gjatë gjithë kohës, bashkëpunimi do të jetë në nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe etike.
3. Shitësi garanton se mallrat e shitura përmes kësaj marrëveshje janë në përputhshmëri të plotë me standardet e parapara ligjore,
4. Anëtari i Sindikatës obligohet të pranojë mallrat e blera dhe të paguajë çmimin në përputhje me nenin 3 të kësaj marrëveshje
5. Palët pajtohen se për çdo ndryshim eventual të të dhënave si: emri, numri i biznesit, numri fiskal, numri i TVSH-së, selia, adresa elektronike (e-mail) apo të dhëna të tjera, do t'a njoftojnë njëra tjetrën me shkrim menjëherë në ditën e ndryshimit.
6. Sindikata është e detyruar që në rast të humbjes së kartelave të furnizimit nga ndonjë Anëtar i Sindikatës, menjëherë të lajmërojë shitësin për humbjen e kartelës dhe anulimin e të njejtës. Njoftimi duhet të bëhet me shkrim.
7. Në rast të kërkesës nga HIB Petrol, Sindikata është e obliguar që të dërgojë Listën e të gjithë anëtarëve të saj.

Neni 5 - Amandamenti i marrëveshjes dhe Njoftimet

1. Asnjë marrëveshje që pretendon se e amandamenton, modifikon, ndryshon, shpjegon ose plotëson dispozitat ose kushtet e kësaj marrëveshje nuk do të jetë e obligueshme për palët përderisa ndryshimet e tilla nuk janë bërë me shkrim dhe nuk janë nënshkruar nga të dyja palët.
2. Njoftimet në lidhje me këtë marrëveshje duhet të bëhen me shkrim dhe t'i dërgohen palës tjetër me postë ose me email në adresat:

HIB Petrol SH.P.K.

Adresa: Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj
Email: artan.thaqi@hibpetrol.com

Sindikata e Policisë së Kosovës

Adresa: Rr. Luan Haradinaj, Prishtinë
Email: sindikatapk@spk-rk.eu

Neni 6 - Shkëputja e marrëveshjes

1. Njëra palë mund të shkëpusë marrëveshjen në rast se një shkelje materiale e marrëveshjes është shkaktuar nga pala tjetër, ose një seri e vazhdueshme e shkeljeve më të vogla të cilat vlerësohen së bashku përbëjnë shkelje materiale. Në rast të një shkelje të përmirësueshme, pala e dëmtuar do t'i ofrojë palës tjetër një njoftim me shkrim për shkeljen dhe do t'i ofrojë tri (3) ditë (ose një periudhë tjetër të theksuar në njoftim) për të përmirësuar shkeljen, dhe nëse dështon në këtë mund të shkëpusë marrëveshjen.
2. Një palë mund të shkëpusë marrëveshjen menjëherë për një shkelje materiale të papërmirësueshme.
3. Përveç arsyeve si më lartë, secila palë mund të shkëpusë marrëveshjen njëanshëm, me një njoftim paraprak 30 (tridhjetë) ditë përpara. Njoftimi duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet përmes postës ose email-it.

Neni 7 – Forca madhore

1. Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse nën këtë marrëveshje nëse dhe përderisa ajo vonesë në përbushje ose dështimi për të përbushur obligimet e saj të përcaktuara me këtë marrëveshje vjen si rezultat i një ngjarje të forcës madhore e cila është përtej kontrollit të palës së afektuar. Forca madhore përfshin, por nuk kufizohet në, rastet e fatkeqësive natyrore si termetet, përmbytjet, zjarret, pandemitë, epidemitë, gjendja e luftës, gjendja e jashtëzakonshme, aktet e Qeverisë, restriksionet qeveritare, ndryshimet në legjislacion, ndonjë vendim apo urdhëresë e institucioneve dhe të ngjashme, si dhe çdo ngjarje tjetër që është përtej kontrollit të palës.
2. Në rastin e forcës madhore, pala e afektuar do të njoftojë menjëherë palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkaktarët.

Neni 8 - Konfidencialiteti

1. I gjithë informacioni që shitësi merr nga blerësi dhe anasjelltas, do të konsiderohet si sekret tregtar dhe duhet trajtuar në përputhje me kërkesat për ruajtjen e fshehtësisë së tij.
2. Palët pajtohen që asnjë dokument, informacion apo material në dispozicion të tyre në kuadrin e aktiviteteve të përcaktuara në këtë marrëveshje ose në ndonjë mënyrë tjetër, nuk do të bëhet i disponueshëm për palë të treta të paautorizuara.
3. Përrjashtohen nga ky rregull vetëm rastet kur marrëveshja dhe përmbajtja e saj kërkohet detyrimisht me ligj, për t'iu bërë e njohur organeve kompetente shtetërore.

Neni 9 - Ligji i aplikueshëm dhe Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo marrëveshje do të interpretohet në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
2. Palët bien dakord se çdo mosmarrëveshje apo kontest eventual lidhur me këtë marrëveshje, do të tentojnë ta zgjidhin me mirëkuptim e nëse kjo nuk është e mundur atëherë kompetente për zgjidhjen e kontestit do të jetë gjykata kompetente në Kosovë.

Neni 10 - Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje dhe dokumentet e bashkangjitura përbëjnë marrëveshjen e plotë të palëve dhe shfuqizon të gjitha marrëveshjet e tjera verbale apo me shkrim.
2. Palët deklarojnë se e kanë lidhur këtë marrëveshje me vullnet të lirë pa kurrfarë dhune, kërcënimi, mashtrimi, kanosje apo lajthimi.
3. Kjo marrëveshje është përpiluar në 2 (dy) kopje identike të së njëjtës përmbajtje, nga 1 (një) për secilën palë.

NËNSHKRIMET E PALËVE

HIB Petrol SH.P.K.



z. Etrit Ademaj, sipas Autorizimit



Sindikata e Policisë së Kosovës

Imir Zeqiri, Kryetar